

Deklarata e AOM Prishtinë *25 maj 2023, Prishtinë – Kosovë*

Ne, Institucionet e Ombudsmanëve dhe të Ndërmjetësimit, u mbledhëm më 24-25 maj 2023 në Prishtinë, Kosovë, me rastin e Takimit të 12-të të Asociacionit të Ombudsmanëve të Mesdheut (AOM);

Duke ripërsëritur se të drejtat e njeriut janë universale, të pandashme dhe të ndërvarura dhe se Institucionet e Ombudsmanëve, të Ndërmjetësimit dhe Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (NHRI) kanë një rol thelbësor në sistemin e të drejtave të njeriut;

Të përkushtuar në promovimin e bashkëpunimit ndërkufitar, regional dhe ndërkombëtar, me qëllim të mbrojtjes efikase të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore dhe të vendosur ta rivedinojmë Mesdheun nga një det që na ndan në një det që na bashkon, siç theksohet në Deklaratën e Nafplionit të AOM-së, të 5 tetorit 2021;

Duke parë se Institucionet e Ombudsmanëve përbëjnë pjesën integrale të qeverisjeve demokratike dhe kanë rol vendimtar për sa i përket sundimit të ligjit, mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut, por edhe të mbikëqyrjes së zbatimit efikas të detyrimeve dhe të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut;

Duke pranuar se integriteti dhe pavarësia janë parime kryesore që duhet ta drejtojnë punën e Institucioneve të Ombudsmanëve, Ndërmjetësimit dhe Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (NHRI) dhe gjithashtu janë themele mbi të cilat ato duhet të ndërtohen;

Duke rikujtuar [Resolutën](#) e Kombeve të Bashkuara për rolin e Institucioneve të Ombudsmanëve dhe të Ndërmjetësimit në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, më 16 dhjetor 2020, si dhe parimet që lidhen me statusin e Institucioneve Kombëtare për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Parimet e Parisit ([Paris Principles](#)) dhe parimet për mbrojtjen dhe promovimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, Parimet e Venecias ([Venice Principles](#));

Duke shprehur shqetësimin e madh për kushtet sfiduese të punës, kërcënimet dhe sulmet që po përjetojnë Institucionet e Ombudsmanëve dhe ato të Ndërmjetësimit si dhe personeli i tyre, që përbëjnë një kërcënim real për pavarësinë dhe efektivitetin e këtyre institucioneve si mbrojtës të të drejtave të njeriut si dhe ndikimin negativ që këto kanë në të drejtat e njeriut në përgjithësi;

Duke e pasur të qartë se pavarësia e institucioneve të të drejtave të njeriut nuk mund të garantohet pa financim dhe infrastrukturë të duhur dhe se shkurtimet buxhetore mund të ndikojnë dhe ta minojnë pavarësinë dhe efikasitetin e tyre;

Mbledhjes së 12-të të Asociimit tonë ia dedikojmë diskutimeve rreth tri çështjeve në vijim:

- Pavarësisë, si element thelbësor i një Institucioni efikas të Ombudsmanit,
- Institucionet e Ombudsmanëve nën kërcënim – sfidat dhe mundësitë,
- Ruajtja e pavarësisë së Institucioneve të Ombudsmanëve – rruga përpara.

Përmes kësaj deklarojmë si më poshtë:

1. AOM-i inkurajon anëtarët e saj t'i vazhdojnë përpjekjet e tyre në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore në vendet e tyre përkatëse dhe të bëjnë trysni tek aktorët shtetërorë për t'u përmbajtur standardeve ndërkombëtare në lidhje me institucionet e pavarura të të drejtave të njeriut, veçanërisht në lidhje me reagimin ndaj kërcënimeve dhe pavarësinë në kryerjen e mandateve të tyre.

2. AOM-i u kërkon të gjitha vendeve në rajonin e Mesdheut dhe në zonat fqinjë, në kuadër të mandateve dhe të përgjegjësisë të tyre, të:
 - a) sigurojnë një bazë të fortë ligjore për institucionet e Avokatit të Popullit, mundësisht në nivel kushtetues, e cila garanton pavarësinë e tyre dhe ua siguron atyre mjetet e nevojshme për kryerjen e funksioneve të tyre në mënyrë efikase, si në nivel kombëtar, ashtu edhe në atë ndërkombëtar;
 - b) sigurojnë që Institucionet e Ombudsmanëve të gëzojnë pavarësi organizative, administrative dhe financiare në zbatimin e mandateve të tyre;
 - c) përmbahen nga çdo veprim që synon ose rezulton në cenimin e integritetit dhe të pavarësisë së Institucioneve të Ombudsmanëve dhe nga çdo kërcënim ndaj institucioneve të tilla dhe të personelit të tyre;
 - d) sigurojnë mjedise të përshtatshme, burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për t'i kryer mandatet e tyre;
 - e) sigurojnë që procesi i emërimit të Avokatit të Popullit, të zëvendësve dhe i stafit të tij të jetë objektiv, i bazuar në merita dhe pa asnjë ndërhyrje politike;
 - f) sigurojnë gëzimin e imunitetit funksional nga ndjekja penale, padia civile dhe shkarkimi për shkak të deklaratave të folura ose të shkruara mbi aktivitetet ose vendimet që janë në kuadër të përgjegjësisë të Avokatit të Popullit dhe të stafit të tij, të cilat duhet të vazhdojnë edhe pas përfundimit të mandatit të tyre,
 - g) t'u referohen standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, siç janë: Parimet e Parisit dhe Parimet e Venecias, kur ndërmerren reforma legjislativë për sa u përket Institucioneve të Ombudsmanëve.

3. AOM-i tërheq vëmendjen e organizatave ndërkombëtare dhe të atyre rajonale të të drejtave të njeriut, siç janë: OHCHR/GANHRI, Këshilli i Evropës, ODIHR, IOI dhe rrjetet e tjera rajonale, ta ngrenë zërin e tyre në mbështetje të forcimit të Institucioneve të Ombudsmanëve, të NHRI-ve dhe të atyre të Ndërmjetësimit, në përputhje me Parimet e Parisit dhe të avokojnë në ofrimin e një mjedisi të favorshëm, në të cilin ata mund ta rrisin maksimalisht ndikimin dhe qëndrueshmërinë e tyre në kryerjen e mandateve të tyre.